

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Burim Shala, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve S.S. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, ....., Kanada, A.S.2. .... Kanada, L.S., ....., Prishtinë, E.S., rr.“.....”, M.S., ....Ontario ..., Kanada, B.S., fshati ..., Komuna e Lipjanit, të cilët në bazë të autorizimit i përfaqëson av. N.P. nga Prishtina, ..., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Insig” sh.a, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga B.D., me objekt të padisë kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1379/08, të datës 03.02.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **12.12.2018**, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Insig” sh.a, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1379/08, i datës 03.02.2015, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.1379/08, të datës 03.02.2015, në pjesën e parë të dispozitivit pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve S.S., A.S.1, A.S.2., L.S., E.S., M.S. dhe B.S., që të gjithë nga fshati .., Komuna Lipjan dhe detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Insig”, me seli në Prishtinë që paditësve-anëtarëve të familjes së të ndjerit K.S., në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit me datën 20.07.2005 nga baza e autopërgjegjesisë, t’ia paguajë shumat si në vijim: në emër të dëmit jo material për dhembjet shpirtërore të përjetuara për shkak të vdekjes së bashkëshortit dhe babait: -bashkëshortes S.S., shumën prej 5.000 euro, - djalit M.S., shumën prej 5.000 euro, - vajzës B.S., shumën prej 5.000 euro, - vajzës A.S.1, shumën prej 5.000 euro, - vajzës E.S., shumën prej 5.000 euro, -vajzës L.S., shumën prej 5.000 euro, të gjitha me kamatë siç i paguajnë bankat për mjetet pa destinacion të caktuar, të afatizuara mbi 12 muaj, duke filluar nga data 11.07.2008 gjer në pagesën definitive, ndërsa në emër të dëmit material, shumat si në vijim dhe atë për shpenzimet në emër të pritjes dhe shpenzimeve të varrimit, shumën prej 1.500 euro si dhe në emër të ngritjes së përmendores, shumën prej 1.316 euro. Me pjesën e dytë të dispozitivit është detyruar e paditura që t’i paguajë shpenzimet gjyqësore në shumë të përgjithshme prej 990 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm. Ndërsa me pjesën e tretë të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve bashkëshortes S.S., djali M.S., vajzave B., A1., A2., E. dhe L.S., mbi shumën e gjykuar për dhimbjet shpirtërore për secilin

paditës mbi shumën prej 5.000 euro, e deri në shumën prej 6.000 euro, si dhe në emër të dëmit material për shpenzimet e pritjes dhe të varrimit, shumën prej 1.000 euro dhe për shpenzimet e ngritjes së përmendores, shumën prej 564 euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë e paditura, përmes të autorizuarit të saj, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të priset aktgjykimi i atakuar dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje, apo të njëjtin t'a ndryshojë ashtu që gjykata e shkallës së dytë të vendos vetë lidhur me kërkesëpadinë.

Paditësit nuk kanë paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është **e pa bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 11.07.2008, asokohe në Gjykatën Komunale në Prishtinë, paditësit S.S., A.S.1, A.S.2., L.S., E.S., M.S. dhe B.S., kanë paraqitur padi (të precizuar në seancën përgatitore të datës 26.01.2015), kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Insig" me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve t'ia kompensoj dëmit material dhe jomaterial dhe atë: për shpenzimet e varrimit të të ndjerit K.S. shumën prej 2.500 euro, për ngritjen e përmendores, shumën prej 1880 uro, për dhembje shpirtërore për shtatë anëtarët e familjes së ngushtë të të ndjerit, për secilin veç e veç shumën prej 6.000 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si në vijim: raportin e aksidentit nr.12536, i datës 20.07.2005, ekspertiza e ekspertit të komunikacionit, e datës 09.11.2005, Y.K. të dhenë në procedurë penale, çertifikata e vdekjes nr.1405 e të ndjerit K.S., e datës 14.03.2008, aktgjykimi penal P.nr.650/2005, e datës 17.03.2006, çertifikata e martesës nr.131, e datës 14.03.2008, çertifikata e lindjes nr.729 në emër të S.M. e datës 17.03.2008, çertifikata nr.179, e datës 14.03.2008, në emër të A.S.1, çertifikata nr.147/1975, e datës 23.03.2008 në emër të A.S.2., çertifikata nr.02/1987, e datës 23.03.2008 në emër të L.S., çertifikata nr.208/1979, e datës 23.03.2008 në emër të E.S., çertifikata nr.484/1980, e datës 23.03.2008 në emër të M.S., çertifikata nr.672/1985, e datës 23.03.2008 në emër të B.S., fatura nr.80194269 lëshuar nga NPT "NN" në Prishtinë me nr. të protokollit 03/06, e datës 14.02.2006, ekspertiza mjekësore e ekspertës dr .N.M.-Psikiatre, e datës 16.09.2013, deklarata e bashkësisë familjare nr.13/13001/3, e datës 27.01.2015, si dhe pas vlerësimit të këtyre provave dhe të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1379/08, të datës 03.02.2015, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, ka theksuar se nuk është kontestues fakti që aksidenti ka ndodhur me datën 20.07.2005, në magjistralen Prishtinë-Ferizaj, në territorin e fshatit Banullë, Komuna e Lipjanit, afër pompës së benzinës “Banulla Petrol”, në momentin e shkaktimit të aksidentit, i siguruari tek e paditura N.N drejtonte automjetin Audi 89, me targa të regjistrimit XYZ-KS-XYZ, duke mos ja përshtatur shpejtësinë e automjetit kushteve në trafik, papritmas nga ana e djathtë në drejtim të lëvizjes së automjetit, me qëllim për të kaluar rrugën në anën e majtë, i ka dalur këmbësori-tani i ndjeri K.S., të cilin e ka goditur me pjesën e përparme të anës së majtë e më pas ka renë në pjesën e majtë të parafangos dhe ka përfunduar në shiritin e majtë të lëvizjes së automjetit, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore nga të cilat ka vdekur në QKUK Prishtinë, poashtu kontribues në këtë aksident ka qenë edhe tani i ndjeri. Më tutje ka shtuar se bazën juridike të kërkesëpadisë e ka vërtetuar përmes raportit të aksidentit nr.12536, i datës 20.07.2005, aktgjykimi penal P.nr.650/2005, i datës 17.03.2006 dhe ekspertizës së komunikacionit të hartuar nga eksperti Y.K., i cili ka ardhur në përfundim se në rastin konkret kemi ndarje të përgjegjësisë në mes shkaktarit të aksidentit dhe vetë të ndjerit, pasi që edhe ky i fundit me veprimet e tij kishte kontribuar në këtë aksident, veprime këtu të përshkruara më hollësisht në ekspertizën e komunikacionit të cekur më lartë. Në këtë rast e paditura mban përgjegjësinë për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial paditësve dhe atë konform dispozitës së nenit 178 al.2 të LMD-së. Më pas gjykata e shkallës së parë ka cekur se për dhimbjet shpirtërore që kanë pësuar paditësit dhe format e reagimit ka marrë për bazë mendimin e ekspertës mjekësore nga lëmia e psikiatrisë dr.N.M., lidhur me natyrën e dhimbjeve shpirtërore dhe pasojave, duke marrë për bazë vlerësimet mjekësore, bazuar në nenin 201 paragrafi 1 të LMD-së ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve në shumat e elaboruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Në shumat e gjykuara, gjykata ka aprovuar edhe kërkesën për dëmin material dhe atë në kuptim të dispozitave nga neni 193 të LMD-së, ndërsa për kamatën e gjykuar ka vendosur në bazë të nenit 186 dhe 277 të LMD-së, si dhe kërkesat për shpenzimet e procedurës bazuar në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat të cilat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe për vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me dhimbjet shpirtërore dhe pasojat për paditësit, si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për shumat e aprovuara, për llojet e dëmit dhe format e tij të kërkuara nga paditësit. Në të drejtim, Gjykata e Apelit e pranon në tërësi edhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit, ndërsa të njëjtën nuk e ka kontestuar as e paditura, pasi që me prova konkrete është vërtetuar se automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti, si pasojë e të cilit ka mbetur i vdekur K.S. ka qenë i siguruar tek e paditura, ndërsa drejtuesi i automjetit është shpallur fajtor me aktgjykimin penal të formës së prerë P.nr.650/2005, datë 17.03.2006.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë pasojat nga aksidenti në të cilën ka humbur jetën familjari i këtu paditësve dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, siç janë natyra dhe kohëzgjatja e dhimbjeve shpirtërore, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve, moshja e të aksidentuarit, si dhe rrethanat tjera, praktikën gjyqësore, rezulton se shumat e gjykuara janë në përputhje me qëllimin e kompensimit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së dhimbjeve shpirtërore, përkatësisht humbjes që kanë pësuar paditësit, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit, duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla. Kjo parashihet me nenin 200 parag. 1 dhe 2, lidhur me nenin 201 të LMD-së, të cilat dispozitat gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të saktë i ka zbatuar me rastin e vendosjes sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në këtë drejtim, edhe pretendimet ankimore të palës paditëse me të cilat i ka kontestuar shumat e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë në emër të kompensimit të dëmit paditësve, janë të pa bazuara, pasi që gjykata të njëjtat shuma i ka gjykuar në përputhje të plotë me dhimbjet shpirtërore të paditësve dhe pasojat e tyre, të përcaktuara në bazë të ekspertizës së ekspertit të psikiatrisë, duke marrë për bazë edhe kontributin e të ndjerit në shkaktimin e aksidentit, kontribut ky i përcaktuar në ekspertizën e ekspertit Y.K. të datës 09.11.2005.

Gjykata e Apelit ka pranuar në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me mënyrën e vendosjes për pjesën e kërkesëpadisë së paditësve për obligimin e të paditurës që të paguajë dëmin material në emër të shpenzimeve të varrimit dhe ngritjes së përmendorës për të ndjerin K.S., pasi që e drejta e paditësve për të kërkuar këtë lloj kompensimi bazohet në nenin 193.1 të LMD-së që ka qenë në fuqi në kohën e ndodhjes së aksidentit. Ndërsa

lartësia e kompensimit nga gjykata e shkallës së parë është gjykuar në mënyrë të drejtë dhe atë në bazë të provave materiale përkatëse të dorëzuara nga pala paditëse, të cilat janë cekur më lartë.

Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me kamatën e gjykuar, pasi në këtë rast kemi aplikim të saktë të së drejtës materiale, ashtu siç e përcakton neni 277 u LMD-së. Gjithashtu edhe pjesa e vendosjes së gjykatës së shkallës së parë në lidhje me shpenzimet e procedurës është marrë në përputhje të plotë me nenin 452.1 të LPK-së, lidhur me TA-në.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Ac.nr.2719/2015, datë 12.12.2018**

**Kryetari i kolegjit,  
Lumni Sallauka, d.v**